



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.178

dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7215 datë 26.12.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	10049
Vendim i KM nr.867, datë 6.12.2011	Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te bashkia Kamëz, Tiranë, të pronës nr.198, me emërtim “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, me vendndodhje në Frutikulturë Kamëz, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	10050
Vendim i KM nr.885, datë 21.12.2011	Për një shtesë në vendimin nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	10050
Vendim i KM nr.888, datë 21.12.2011	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Spitalit Ushtarak, Gjirokastër, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Brendshme, dhe për një shtesë në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.....	10051
Vendim i KM nr.889, datë 21.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemim-asfaltimi i sheshit të Pallatit të Sportit, në bashkinë e Shkodrës.....	10053

Vendim i KM nr.890, datë 21.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë 2 - Elbasan 2, qarku Tiranë, komnat Vaqar, Kërrabë dhe Petrelë.....	10054
Vendim i KM nr.891, datë 21.12.2011	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit për disa tendera të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, si autoritet kontraktor.....	10056
Vendim i KM nr.892, datë 21.12.2011	Për miratimin e rregullores “Për formalitetet e anijeve që operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë”.....	10056
Vendim i KM nr.893, datë 21.12.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, të ndryshuar	10066
Vendim i KM nr.894, datë 21.12.2011	Për licencimin e Akademisë Pedagogjike, Tiranë.....	10067
Vendim i KM nr.895, datë 21.12.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.306, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe procedurat e përjashtimit”, të ndryshuar.....	10069
Vendim i KM nr.897, datë 21.12.2011	Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes	10071
Vendim i KM nr.898, datë 21.12.2011	Për shpalljen e ekosistemit natyror malor Korab - Koritnik “Park natyror”.....	10081
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Drita Kuburja....	10085

DEKRET
Nr.7215, datë 26.12.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 14, 20 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Vasil Kristo Taba | 23. Afroviti Hajdar Sulejman (Sulejmani) |
| 2. Arben Adem Latifaj | 24. Jorgji Leonidha Shaka |
| 3. Landi Mitro Hali | 25. Vasil Leonidha Mako |
| 4. Shpetim Shefqet Kelmendi | 26. Vasillo Leonidha Mingo |
| 5. Liljana Refat Kelmendi | 27. Enver Ismet Smira |
| 6. Fatbardha Qemal Zyka (Selamaj) | 28. Ramazan Sulejman Doda |
| 7. Mehdi Faiz Asllani | 29. Adriatik Xhelal Ibrahim |
| 8. Argjentina Abedin Asllani (Bebeti) | 30. Mirela Kostaq Ibrahim |
| 9. Agim Xhafer Sulejmani | 31. Xhim Xhelal Ibrahim |
| 10. Mikail Xhafer Goça | 32. Eliona Kujtim Ibrahim |
| 11. Shefiko Xhevdet Goça | 33. Valbona Vath Ekonomi (Masha) |
| 12. Lorenc Mikail Goça | 34. Marije Nikoll Kuri |
| 13. Lindita Kristo Meço | 35. Lulzim Shefqet Jahja |
| 14. Petrika Foto Bacu | 36. Vanthi Vasillaq Dhima |
| 15. Engjellushe Shefqet Pazaj | 37. Sofia Thimio Kostandini |
| 16. Arben Dylaver Noka | 38. Igli Fatbardh Deliallisi |
| 17. Besar Mehdi Asllani | 39. Eugen Fatbardh Deliallisi |
| 18. Drilon Mehdi Asllani | 40. Jorgjia Koço Vasi |
| 19. Mustafë Muhamet Kapijaj | 41. Majlinda Fadil Ymeri (Popoviç) |
| 20. Besnik Muhamet Kapijaj | 42. Piro Koci Prifti |
| 21. Amir Muhamet Kapijaj | 43. Eva Piro Prifti |
| 22. Gjinovefa Gjisho Ibruli | 44. Vasile Miha Dhimitri |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi



VENDIM
Nr.867, datë 6.12.2011

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE BASHKIA KAMËZ, TIRANË, TË PRONËS NR.198, ME EMËRTIM “QZE (PRT) E REPARTIT USHTARAK NR.3030”, ME VENDNDODHJE NË FRUTIKULTURË KAMËZ, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te bashkia Kamëz, Tiranë, të pronës nr.198, me emërtim “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, me vendndodhje në Frutikulturë Kamëz, Tiranë, për ta përdorur për kryerjen e investimeve publike për ngritjen e një qendre shëndetësore dhe për ndërtimin e një shkolle të re.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr.198, “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, në Frutikulturë Kamëz, Tiranë.

3. Bashkisë Kamëz, Tiranë, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr.198, me emërtim “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, në Frutikulturë, Kamëz, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, kryetari i bashkisë Kamëz, Tiranë, dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.885, datë 21.12.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 11/1 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 11/2, me këtë përmbajtje:

“11.2. Shtetasit e vendeve anëtare të INTERPOL-it, të cilët mbajnë pasaportën e INTERPOL-it, të miratuar me rezolutën nr.AG-2010-RES-02, datë 9.11.2010, mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë për nevoja pune, e konfirmuar kjo me autorizim të posaçëm të lëshuar nga autoritetet homologe të Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, pa pasur nevojë të pajisen me vizë nga autoritetet shqiptare apo të përdorin ndonjë dokument tjetër udhëtimi, si dhe të qëndrojnë deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda periudhës së përcaktuar 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e hyrjes së parë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.888, datë 21.12.2011

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË SPITALIT USHTARAK, GJIROKASTËR, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E BRENDSHME, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Spitalit Ushtarak, Gjirokastrë, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Brendshme.

2. Në listën e pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet prona Spitali Ushtarak, Gjirokastrë, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror MB (njësia rajonale e policisë rrugore Gjirokastrë) Bashkia/komuna Grehot Fusha e përdorimit të pronës: Policia Rrugore										
Nr. rendor	A		B				C			
	Zona kadastrale, indeks i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë		Truall	5261.7		Ministria e Brendshme	Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë	Nga matjet faktike të inxh. të licencuar të sipërfaqes totale dhe të ndërtesave rezultojnë: sipërfaqe trualli 5 261.7 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 1 134 m ² , konkretisht: Godina kryesore 1045 m ² Godina nr.1 – 11 m ² Godina nr.2 – 18 m ² Godina nr.3 – 60 m ²
2				Godina kryesore	Pikë referimi	1045		Ministria e Brendshme	Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë	
3				Godina nr.1	Veri-Perëndim	11		Ministria e Brendshme	Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë	
4				Godina nr.2	Veri-Perëndim	18		Ministria e Brendshme	Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë	
5				Godina nr.3	Jug-Perëndim	60		Ministria e Brendshme	Njësia rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë	

VENDIM
Nr.889, datë 21.12.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIM-ASFALTIMI I SHESHIT
TË PALLATIT TË SPORTIT, NË BASHKINË E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemim - asfaltimi i sheshit të Pallatit të Sportit, në bashkinë e Shkodrës.
 2. Pronarët e pasurive pronë private, që shpronësohen për sipërfaqen prej 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) m² truall, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, është 10 008 000 (dhjetë milionë e tetë mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e saj.
 4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të këtij projekti.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Shkodrës.
 6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Shkodrës, për realizimin e këtij projekti.
 7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) m² truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Shkodrës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen bashkia e Shkodrës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “SISTEMIM-ASFALTIMIN E SHESHIT TË PALLATIT TË SPORTIT”
NË BASHKINË E SHKODRËS**

Nr.	Emrat e pronarëve	Sip. truall m ²	Çmimi lekë m ²	Vlera e truallit në lekë	Zona kadastrave	Numri i pasurisë	Dok. i pronësisë
1	Muhamet Dervishi	214	24 000	5 136 000	8591	7/350	Certifikatë pronësie
2	Sadete Dervishi						
3	Skender Dervishi						
4	Mehdi Dervishi						
5	Agim Dervishi						
6	Syrri Dervishi						
7	Myzejen Dervishi						



1	Muhamet Dervishi	203	24 000	4 872 000	8591	7/230	Certifikatë pronësie
2	Sadete Dervishi						
3	Skender Dervishi						
4	Mehdi Dervishi						
5	Agim Dervishi						
6	Syrri Dervishi						
	Shuma totale	417	24 000	10 008 000			

VENDIM
Nr.890, datë 21.12.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV TIRANË 2 - ELBASAN 2, QARKU TIRANË, KOMUNAT VAQAR, KËRRABË DHE PETRELË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë 2 - Elbasan 2, qarku Tiranë, komunat Vaqar, Kërrabë dhe Petrelë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme të shpronësimit prej 241 (dyqind e dyzet e një) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 3 623 400.00 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e tri mijë e katërqind) lekësh.

4. Fondi prej 3 623 400.00 (tri milionë e gjashtëqind e njëzet e tri mijë e katërqind) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2011 dhe të përfundojë brenda muajit mars 2012.

6. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE ME REFLEKTIMIN E NDRYSHIMEVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LTL 400 KV TIRANË 2 - ELBASAN 2, QARKU TIRANË

Nr.	Objekti	Shpronësimi definitiv										Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit	Dokumentacioni
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Nr. i shtyllës	Sasia, shpronësim definitiv m ²	Çmimi i shitjes ZRPP lekë/m ²	Vlera kompensimit			
1	ltl 400	Zef	Pal	Prenga	Zdrukhtari	2376	179/5	16-17	33	54900	1,811,700	1,811,700	Vaqar	Me certifikatë pronësie
2	ltl 400	Flamur	Agron	Xhabafti	Lokal	1315	40/1	30-31	33	54900	1,811,700	1,811,700	Vaqar	Planimetri ALUIZNI
3	ltl 400	Bihane	Ali	Saliu	Arë	3471	142/2	73	90	0	0	0	Krrabë	Me certifikatë pronësie
4	ltl 400	Qamil	Nuredin	Pareshi	Arë	1/25/1908	5/221	41	85	0	0	0	Petrelë	Me certifikatë pronësie
		SHUMA								241 m²		3,623,400		



VENDIM
Nr.891, datë 21.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PËR DISA TENDERA TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, si autoritet kontraktor, deri në datën 26.12.2011, për tenderat me objektet e prokurimit, si më poshtë vijon:

a) “Përfundimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën Përroi i Agait - Qerret, loti I (fshati Golem, linjat KUZ, stacioni i pompave nr.2 deri te stacioni i pompave nr.4)”;

b) “Përfundimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën Përroi i Agait - Qerret, loti II (linjat KUZ, Përroi i Agait, stacioni i pompave nr.1 deri te stacioni i pompave nr.2)”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës - Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.892, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FORMALITETET E ANIJEVE QË OPEROJNË NË PORTET DETARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9428, datë 13.10.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për krijimin e lehtësirave për trafikun ndërkombëtar detar (Londër, më 9 prill 1965)””, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për formalitetet e anijeve që operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr.465, datë 6.10.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për bashkërendimin e veprimeve të organeve të kontrollit shtetëror dhe subjekteve që veprojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë””, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e tjera shtetërore, si dhe organet që kryejnë aktivitetet në portet detare për kontrollin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

¹ Direktiva 2002/6/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian e 18 shkurtit 2002 “Mbi raportimin e formaliteteve për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e shteteve anëtare të Komunitetit”, me nr.CELEX 32002L0006. 10056

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
MBI FORMALITETET E ANIJEVE QË OPEROJNË NË PORTET DETARE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është lehtësimi i transportit detar, duke ofruar formalitete raportimi standarde në përputhje me konventën “Për krijimin e lehtësirave për trafikun ndërkombëtar detar (Londër, më 9 prill 1965)” (konventa FAL), në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9428 datë 13.10.2005, si dhe direktivën 2002/6/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian e 18 shkurtit 2002 mbi “Raportimin e formaliteteve për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e shteteve anëtare të komunitetit” me nr.CELEX 32002L0006.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet për formalitetet e raportimit në mbërritje dhe/ose në nisje nga portet shqiptare, siç përcaktohet në aneksin I, pjesa A, lidhur me anijen, mallin që transporton, furnizimet e saj, sendet e ekuipazhit të saj, listën e ekuipazhit dhe në rastet e anijeve të certifikuara për të transportuar deri në 12 pasagjerë, listën e pasagjerëve.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) Konventa IMO FAL: nënkupton Konventën e Organizatës Ndërkombëtare Detare “Për krijimin e lehtësirave për trafikun ndërkombëtar detar” (Londër, më 9 prill 1965), e adoptuar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi Lehtësimin e Transportit dhe Udhëtimit Detar, më 9 prill 1965, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9428 datë 13.10.2005;

b) Formularët IMO FAL: nënkuptojnë modelet e standardizuara A4 të aprovuara në kuadrin e konventës IMO FAL;

c) Formaliteti i raportimit: nënkupton informacionin që duhet të jepet, kur kërkohet nga autoritetet shqiptare, për qëllime administrative dhe procedurale kur një anije mbërrin ose largohet nga një port;

d) Anije: nënkupton një anije detare të çdo tipi që operon në mjedisin detar;

e) Furnizimet e anijes: mallrat për përdorim në anije, duke përfshirë mallrat e konsumueshme, mallrat e transportuara për shitje ndaj udhëtarëve dhe anëtarëve të ekuipazhit, karburantin dhe vajrat, por duke përjashtuar pajisjet e anijes dhe pjesët e këmbimit të anijes.

f) Pajisjet e anijes: artikuj, përveçse pjesëve të këmbimit të anijes, në bordin e një anijeje për përdorim, të cilat janë të heqshme, por jo të natyrës së konsumueshme, duke përfshirë, të tilla si: sanallet, pajisjet e shpëtimit, furnizimet, veshjet e anijes dhe pika të ngjashme.

g) Pjesët e këmbimit të anijes: artikujt e natyrës së riparimit ose zëvendësimit për inkuorporim në anije në të cilën ato transportohen.

h) Plaçkat e ekuipazhit: veshjet, gjëra të përdorimit të përditshëm dhe çdo artikull tjetër, të cilat mund të përfshijnë pare, që i përkasin ekuipazhit dhe që transportohen në anije.



i) Anëtarë të ekuipazhit: çdo person aktualisht i punësuar për detyra në bordin e anijes gjatë udhëtimit në punë ose shërbim në anije dhe i përfshirë në listën e ekuipazhit.

j) Autoritete shqiptare: nënkupton institucione, agjenci ose zyrtarë shqiptarë përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregullave shqiptare, të cilat u përkasin në çdo aspekt praktikave të rekomanduara standarde të përmbajtura në këtë rregullore.

Neni 4

Formalitetet e pranimit

Shqipëria pranon formalitetet e raportimit të cituara në nenin 2 nëse janë përmbushur kërkesat për informacion në përputhje me:

- a) specififikimet përkatëse të përcaktuara në shtojcën I, pjesa B dhe C; dhe
- b) modelet përkatëse të përcaktuara në shtojcën II me kategorizimin e të dhënave.

Neni 5

Komiteti

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare në bashkëpunim me Autoritetin Portual/Portin, doganën, Instituti i Shëndetit Publik, Policinë Kufitare, dhe Kapitanerinë e Portit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, të përfshira në formalitetet e pritjes, do të krijojnë një Komitet Kombëtar FAL, i cili do të sigurojë zbatimin e kësaj rregulloreje në përputhje me konventën FAL.

2. Për ngritjen e Komitetit, institucionet ose autoritetet e përfshira duhet të firmosin një memorandum bashkëpunimi.

3. Sipas marrëveshjes së autoriteteve, në këtë memorandum, si anëtarë Komiteti, mund të shtohen edhe grupe të tjera interesi, si: shoqata e pronarëve të anijeve, shoqata e agjentëve doganorë ose dhoma e tregtisë.

4. Komiteti FAL, i drejtuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare do të mbledhet në mënyrë të rregullt periodike për të siguruar zbatimin e vendimit, për të vlerësuar procedurat për zbatim dhe për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin mes grupeve të interesit të kësaj fushe.

5. Komiteti do të hartojë, miratojë dhe zbatojë rregulloren e tij procedurale.

6. Komiteti do përbëhet me nga një përfaqësues nga institucionet e mëposhtme:

Drejtoria e Përgjithshme Detare, Kapitaneria e Portit, Autoriteti Portual/porti administrata doganore, Policia Kufitare, Instituti i Shëndetit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Neni 6

Zbatimi

Autoritetet shqiptare të përfshira në formalitetet e mbërritjes/nisjes së anijeve, nga portet shqiptare, duhet të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të konventës FAL, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9428 të datës 13.10.2008.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI I

PJESA A

DOKUMENTET KRYESORE QË DUHET TË PARAQESË KAPITENI I ANIJES PËR MARRJEN E PRAKTIKËS SË LIRË

Lista e formaliteteve të raportimit të referuara në nenin 2 në lidhje me mbërritjen/nisjen nga portet shqiptare.

1. Formulari 1 IMO FAL: Deklarata e përgjithshme

Deklarata e përgjithshme duhet të jetë dokumenti bazë në nisjen dhe mbërritjen e anijeve i cili jep informacionin e kërkuar nga autoritetet shqiptare lidhur me anijen.

2. Formulari 2 IMO FAL: Deklarata e ngarkesës

Deklarata e ngarkesës do të jetë dokumenti bazë për nisjen dhe mbërritjen e anijeve dhe duhet të japë informacionin e kërkuar nga autoritetet shqiptare lidhur me ngarkesën. Megjithatë mund të kërkohen, gjithashtu, detaje për ngarkesat e rrezikshme të veçanta.

3. Formulari 3 IMO FAL: Deklarata e furnizimeve të anijes

Deklarata e magazinave të anijes do të jetë dokumenti bazë, në mbërritje dhe nisje, duke dhënë informacionin e kërkuar nga autoritetet publike lidhur me magazinat e anijes.

4. Formulari 4 IMO FAL: Deklarata e sendeve të ekuipazhit

Deklarata e sendeve personale të ekuipazhit do të jetë dokumenti bazë, i cili do të japë informacionin e kërkuar nga autoritetet përkatëse lidhur me sendet personale të ekuipazhit. Ky formular nuk kërkohet në nisje të anijeve.

5. Formulari 5 IMO FAL: Lista e ekuipazhit

Lista e ekuipazhit do të jetë dokumenti bazë që do t'u japë autoriteteve shqiptare informacion lidhur me numrin dhe përbërjen e ekuipazhit në nisje dhe mbërritje të anijes. Kur autoritetet kërkojnë informacion për ekuipazhin në nisje, një kopje e listës e paraqitur në mbërritje, do të pranohet në nisje nëse firmoset serish dhe miratohet për të treguar çdo ndryshim në numër apo përbërje të ekuipazhit ose për të treguar se nuk ka pasur ndryshime të tilla.

6. Formulari 6 IMO FAL: Lista e pasagjerëve

Për anijet e certifikuara për të transportuar deri në 12 pasagjerë, lista e pasagjerëve do të jetë dokumenti bazë që i pajis autoritetet shqiptare me informacion lidhur me pasagjerët në mbërritje dhe/ose nisje të anijes.

7. Dokumenti i kërkuar sipas Konventës universale postare për Postën.

Autoritetet publike nuk do të kërkojnë në mbërritje ose në nisjen e anijes ndonjë deklaratë me shkrim lidhur me postën, përveç atyre të përshkruara në Konventën universale postare.

8. Deklarata detare për shëndetin

Deklarata detare për shëndetin do të jetë dokumenti bazë që jep informacionin e kërkuar nga autoritetet shëndetësore publike, lidhur me gjendjen e shëndetit në bordin e anijes gjatë udhëtimit dhe me mbërritjen në port.

PJESA B

NËNSHKRUESIT

1. Formulari 1 IMO FAL: Deklarata e përgjithshme

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë të përgjithshme të datuar dhe të firmosur nga kapiteni i anijes, agjenti i anijes ose persona të tjerë të autorizuar nga kapiteni apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet.

2. Formulari 2 IMO FAL: Deklarata e ngarkesës

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë për ngarkesën të datuar dhe të firmosur nga kapiteni i anijes, agjenti i anijes ose persona të tjerë të autorizuar nga kapiteni apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet.

3. Formulari 3 IMO FAL: Deklarata e furnizimeve të anijes



Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë të magazinave të anijes të datuar dhe të firmosur nga kapiteni i anijes ose nga oficerë të anijes të autorizuar në mënyrë të rregullt nga kapiteni, që kanë njohuri personale mbi faktet në lidhje me magazinat e anijes apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet.

4. Formulari 4 IMO FAL: Deklarata e sendeve të ekuipazhit

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë të sendeve të ekuipazhit të datuar dhe firmosur nga kapiteni ose nga oficerë të anijes të autorizuar në mënyrë të rregullt nga kapiteni, të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet. Autoritetet shqiptare mund të kërkojnë që çdo anëtar i ekuipazhit të vendosë firmën e tij ose, nëse është i pazoti ta bëjë atë, shenjën e tij, në deklaratën në lidhje me sendet e tij.

5. Formulari 5 IMO FAL: Lista e ekuipazhit

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë për listën e ekuipazhit të datuar dhe të firmosur nga kapiteni i anijes ose nga oficerë të anijes të autorizuar në mënyrë të rregullt nga kapiteni apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet.

6. Formulari 6 IMO FAL: Lista e pasagjerëve

Për anijet që transportojnë jo më shumë se 12 pasagjerë, autoritetet shqiptare do të pranojnë një listë pasagjerësh të datuar dhe firmosur nga kapiteni i anijes, agjenti i anijes ose persona të tjerë të autorizuar në mënyrë të rregullt nga kapiteni apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet.

7. Dokumenti i kërkuar sipas Konventës universale postare për Postën.

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë për postën sipas mënyrës së përshkruar në Konventën universale postare.

8. Deklarata detare për shëndetin

Autoritetet shqiptare do të pranojnë një deklaratë detare për shëndetin e personave në bordin e anijes të datuar dhe firmosur nga kapiteni i anijes ose nga oficerë të anijes të autorizuar në mënyrë të rregullt nga kapiteni apo të vërtetuar në mënyrë të pranueshme për autoritetet, si edhe të kundërfirmosur nga mjeku i anijes (nëse ka).

PJESA C SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Formati i formularëve IMO FAL duhet të jetë sipas modeleve të dhëna në shtojcën II për aq sa është teknikisht e mundur. Formularët duhet të printohen në letër A4 (210mm x 297mm). Të paktën 1/3 e hapësirës duhet lënë për t'u plotësuar nga autoritetet e vendit pritës ose përcjellës.

Për efekt njohjeje pranohen si ekuivalente edhe formatet e miratuara në konventën IMO FAL të datës 1 maj 1997.

2. Autoritetet shqiptare do të pranojnë informacion të përcjellë nga çdo palë e tretë e ligjësuar, përfshirë formularë të plotësuar me bojë apo laps që nuk hiqet ose të prodhuara me mjete të tjera, automatike teknike të përpunimit të të dhënave.

3. Pa paragjykuar metodat e transmetimit të të dhënave me mjete elektronike, kur një autoritet shqiptar pranon transmetimin në formë elektronike, duhet ta bëjë atë vetëm kur plotësohen standardet ndërkombëtare dhe kur jepen të dhëna të mjaftueshme dhe të kuptueshme.

Autoritetet shqiptare pas marrjes së informacionit të nevojshëm mund ta procedojnë atë në çfarëdo formati që e konsiderojnë të përshtatshëm.

ANEKSI II
IMO GENERAL DECLARATION
DEKLARATA E PËRGJITHSHME E IMO
(IMO FAL FORM 1)

		Arrival Mbërritja	Departure Nisja
1.1 Name and type of ship - Emri dhe tipi i anijes 1.2 IMO number - Numri i IMO-së 1.3 Call sign - Shenja e thirrjes		2. Port of arrival /departure Porti i mbërritjes / nisjes	
		3. Date time of arrival/ departure Data dhe koha e mbërritjes/nisjes	
4. Flag State of ship Flamuri i shtetit të anijes	5. Name of master Emri i kapitenit	6. Last port of call /Next port of call Porti i fundit i prekur /Porti i ardhshëm që do prekë anija	
7. Certificate of registry (Port; date; number) Certifikata e regjistrimit (porti, data, numri)		8. Name and contact details of ship's agent Emri dhe detajet e kontaktit të agjentit të anijes	
9. Gross tonnage Tonazhi bruto	10. Net tonnage Tonazhi neto		
11. Position of the ship in the port (birth or station) Pozicioni i anijes në port (nr. i kalatës)			
12. Brief particulars of voyage (previous and sequent ports of call, underline where remaining cargo will be discharged Përshkrim i shkurtër i udhëtimit dhe i porteve që ka prekur, duke theksuar ku do të shkarkohet ngarkesa e mbetur)			
13. Brief description of the cargo Përshkrim i shkurtër i ngarkesës			
14. Number of crew's (incl. Master) Numri i ekuipazhit (duke përfshirë dhe kapitenin)	15. Number of passengeres Numri i pasagjerëve	16. Remarks Shënime	
Attached documents (indicate number of copies) Dokumente të bashkëlidhura (trego numrin e kopjeve)			
17. Cargo Declaration Deklarata e ngarkesës	18. Ship's Stores Declaration Deklarata e magazinave të anijes		
19. Crew List Lista e ekuipazhit	20. Passengers List Lista e pasagjerëve	21. The ship's requirements in terms of waste and residue reception facilities Kërkesat mbi anijen për pajisjet e përpunimit të mbeturinave dhe të plehrave	
22. Crew's Effects Declaration* Deklarata për sendet e ekuipazhit	23. Maritime Declaration of Health* Deklarata shëndetësore detare		

24. Date and signature by master, authorized agent or officer
Data dhe firma e kapitenit, agjentit ose nëpunësit të autorizuar

* only on arrival
Vetëm në mbërritje



IMO PASSENGER LIST
LISTA E PASAGJERËVE
(IMO FAL FORM 6)

				Arrival	Departure	Page Number
1.1 Name of ship – Emri i anijes		1.2 IMO number – Numri IMO		1.3 Call sign – Kodi i thirrjes		
1.4 Voyage number- Numri i udhëtimit		2. Port of arrival/departure – Porti mbërritjes/nisjes		3. Date of arrival/departure – Data mbërritjes/nisjes		4. Flag State of ship – Shteti i flamurit të anijes
5. Family name, given names Mbiemri, emri	6. Nationality Shtetësia	7. Date and place of birth Data dhe vendi i lindjes	8. Type of identity or travel document - Tipi i dokumentit	9. Serial number of identity or travel document - Numri i dokumentit	10. Port of embarkation - Porti i ngarkimit	11. Port of disembarkation - Porti i shkarkimit
						12. Transit passenger or not - Pasagjer transit apo jo
13. Date and signature by master, authorized agent or officer - Data dhe firma e kapitenit, agjentit ose oficerit të autorizuar						

VENDIM
Nr.893, datë 21.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.627, DATË 31.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.627, datë 31.8.2011, të ndryshuar të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011 - 2012, të jenë 9531, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 8650; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuotat për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 400; |
| d) Kuota për personat që nuk shikojnë | 20; |
| dh) Kuota për romët/balkano - egjiptianë | 20; |
| e) Kuota për të përndjekurit politikë | 201.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas kolonës D të tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Rishpërndarja e kuotave të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të përcaktuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 4:1, përkatësisht 80% e tyre, për pranimet e reja në programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 20% për pranimet e reja në programe të dyta studimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.894, datë 21.12.2011

PËR LICENCIMIN E AKADEMISË PEDAGOGJIKE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e Akademisë Pedagogjike, Tiranë, në emër të shoqërisë “Akademia Pedagogjike e Tiranës” sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Akademia Pedagogjike, Tiranë të organizohet në dy fakultete:

- a) Fakulteti i Edukimit, i cili do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në mësuesi:
 - i) Cikli parashkollor;
 - ii) Cikli i ulët;
 - iii) Gjuhë angleze.



- b) Fakulteti i Shkencave Sociale, i cili do të ofrojë programe studimi:
- I. Të ciklit të parë në:
 - i) Pedagogji – histori;
 - ii) Pedagogji speciale;
 - iii) “Gazetari”, me profile:
 - a) Kulturë;
 - b) Arsim;
 - c) Shkencë.
 - II. Të ciklit të dytë “Master profesional”, në:
 - i) Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies.
3. Akademia Pedagogjike, Tiranë do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike dhe që realizohen me 180 kredite. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:
- i) Mësuesi “Cikli parashkollor”;
 - ii) Mësuesi “Cikli i ulët”;
 - iii) Mësuesi “Gjuhë angleze”;
 - iv) Pedagogji – histori;
 - v) Pedagogji speciale;
 - vi) Gazetari, me profile:
 - a) Kulturë;
 - b) Arsim;
 - c) Shkencë.
4. Akademia Pedagogjike, Tiranë do të ofrojë program studimi të ciklit të dytë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1.5 (një pikë pesë) vit akademik dhe që realizohet me 90 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies”.
5. Akademia Pedagogjike, Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.
6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Akademia Pedagogjike, Tiranë duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.895, datë 21.12.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 24.5.2006 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË
PAJISJEVE SPORTIVE, QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE
PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 6 të nenit 7 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.306, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar”.

2. Në pikën 1 pas fjalëve “... detyrimet doganore ...” shtohen “... dhe tatimi mbi vlerën e shtuar...” .

3. Në aneksin 1 bashkëlidhur vendimit bëhen shtesat sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS 1

1. Pas pikës 32 të kapitullit VII “FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT”, të shtohen pikat si më poshtë:

“33. Sistem komunikimi për arbitrat;

34. Fëshfëshe shiu;

35. Xhupa;

36. Tapet sintetik për fusha dhe aksesoret për instalimin e tij;

37. Parket për fusha dhe aksesoret për instalimin e tij;

38. Makineri mirëmbajtjeje për tapet sintetik futsali;

39. Makineri mirëmbajtjeje për parket futsali.”.

2. Pas pikës 11 të kapitullit XIV “FEDERATA SHQIPTARE E QITJES”, të shtohen pikat si më poshtë:

“12. Pajisje për hedhjen e pjatelave në qitjen me pjatel;

13. Veshje speciale për qitjen me pjatel (jelekë, doreza, këpucë, kapele, pantallona, çanta);

14. Fishekë për qitjen me pjatel;

15. Pjatela për qitjen me pjatel.”.

3. Pas pikës 4 të kapitullit XIX “FEDERATA SHQIPTARE E SKIVE”, të shtohen pikat si më poshtë:

“5. Makinë për prodhim bore “Snougan” (topa bore);

6. Makinë për shtypjen e borës dhe përgatitjen e pistës (Batipista);

7. Motor bore transporti dhe emergjence, “Snouxhet”;

8. Mikrobuz transporti për bazë materiale” (copë 1);

9. Pajisje mekanike e rregullimit, kontrollit dhe kolaudimit të skive;

10. Tapet bari plastik për rrëshqitje në kushte verore;

11. Teleferik për ngjitjen e skiatorëve në pistë (copë 1).”.



4. Pas kapitullit XXVII, të shtohen kapitujt, si më poshtë:

“XXVIII. FEDERATA SHQIPTARE E GOLFIT”, me këtë listë materialesh:

1. Çanta golfi;
2. Shkopinj golfi për të gjitha moshat;
3. Topa golfi;
4. Fanella golfi;
5. Pantallona golfi;
6. Xhaketa golfi;
7. Këpucë golfi për të gjitha moshat;
8. Simulator golfi;
9. Sete golfi të kompletuar (çantë, shkopinj, topa, peshqirë, kapele, doreza golfi);
10. Pajisje për mirëmbajtje fushe golfi.”.

XXIX. FEDERATA SHQIPTARE E RAFTING”, me këtë listë materialesh:

1. Gomone;
2. Kanoë;
3. Kayak;
4. Kataraft;
5. Lopata;
6. Skafandra;
7. Veshje *rafting*;
8. Xhup uji;
9. Çorape;
10. Këpucë *rafting*;
11. Kostum sportiv;
12. Bluzë sportive;
13. Xhup sportiv;
14. Kapele;
15. Atlete;
16. Çanta sportive;
17. Aksesorë (litar, bilbil);
18. Prozhektor;
19. Kamerë filmimi antiujë (copë 1);
20. Aparat fotografik antiujë” (copë 1).”.

“XXX. FEDERATA SHQIPTARE E AERONAUTIKËS”, me këtë listë materialesh:

1. Parashuta;
2. Instrumente variometër;
3. Instrumente gps;
4. Sedilje parashutë;
5. Parashuta rezervë;
6. Veshje pilotësh;
7. Kaska;
8. Avionë të vegjël *ultralight*;
9. Parashuta për ngritje nga toka me tërheqje;
10. Pajisje *vericel* për ngritje velash nga toka;
11. Pajisje aerodelizmi fluturuese;
12. Paramotorë;
13. Erika paramotorësh.”.

“XXXI. FEDERATA SHQIPTARE E LUNDRIMIT ME VELA”, me këtë listë materialesh:

1. Barka dhe mjete lundrimi me vela;
2. Barka dhe mjete lundrimi me motor (copë 1);
3. Barka dhe mjete lundrimi me rrema;

4. Kanoë;
5. Kayak;
6. Pajisje për transportimin e barkave në tokë dhe në plazh (karele);
7. Pajisje të bregëzimit të mjeteve dhe barkave;
8. Pajisje të ndriçimit në bord, breg, ujë dhe nën ujë;
9. Veshje sportive;
10. Kayak.”.

“XXXII. FEDERATA SHQIPTARE SPORT PËR TË GJITHË”, me këtë listë materialesh:

- “1. Veshje sportive;
2. Shirita kufizues;
3. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace).”.

VENDIM

Nr.897, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPALLJEN E ZONAVE TË VEÇANTA TË RUAJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 4/3 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpallja e zonave të veçanta të ruajtjes (ZVR) të kryhet mbi bazën e kriterëve dhe vlerësimeve të përcaktuara në nenin 4/3 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe sipas rregullave që përcaktohen në këtë vendim.

2. Zona të veçanta të ruajtjes të shpallen ato territore që ndodhen në zonat e mbrojtura, brenda rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, si dhe ekosisteme, habitate e peizazhe jashtë këtij rrjeti, si më poshtë:

a) Zonat që kanë statusin e zonës Ramsar, si ligatina me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht për shpendët e ujit;

b) Zonat me rëndësi për shpendët;

c) Zonat me interes të veçantë ruajtjeje të identifikuar në kuadrin e zbatimit të konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës), në të cilën Republika e Shqipërisë është palë, ratifikuar me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998;

ç) Zonat që nuk bëjnë pjesë në rrjetin e zonave të mbrojtura apo në zonat e tjera, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të këtij paragrafi.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, mbi bazën e të dhënave ekzistuese, harton një listë paraprake të zonave që potencialisht plotësojnë kriteret për t’u shpallur si ZVR. Lista paraprake e ZVR-ve i nënshtrohet vlerësimit të mëtejshëm, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

4. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve bashkërendon punën me institucionet kërkimore e universitare dhe njësitë e qeverisjes vendore për kryerjen e studimit, me qëllim vlerësimin e zonave potenciale për t’u shpallur zona të veçanta të ruajtjes. Mbi bazën e këtij studimi hartohet një listë paraprake e zonave që potencialisht plotësojnë kriteret për t’u shpallur si ZVR.

5. Rezultatet e vlerësimit dhe të dhënat për çdo zonë u nënshtrohen diskutimeve me publikun, në përputhje me parashikimet e vendimit nr.994, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrjen për mjedisin”.



6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përgatit dokumentacionin për çdo zonë, në të cilin përfshihen edhe mendimet e siguruar dhe ia paraqet për mendim zyrtar ministrive të linjës, prefektëve dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe njësite të qeverisjes vendore.

7. Pas marrjes së mendimit nga ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, ministri miraton, me urdhër, listën e zonave të veçanta të ruajtjes dhe së bashku me të dhënat përkatëse për çdo zonë, ia dërgon Komisionit Europian.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA I
I. IDENTIFIKIMI I ZONËS

1.1 TIPI

--

1.2 KODI I ZONËS

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

1.3. EMRI I ZONËS

--

1.4. DATA E PARË E PLOTËSIMIT

--	--	--	--	--	--

1.5 DATA E PËRDITËSIMIT

--	--	--	--	--	--

1.6 PERSONI PËRGJEGJËS

EMRI /ORGANIZATA:.....
ADRESA:.....
E-MAIL:.....

1.7 TË DHËNAT PËR ZONËN DHE DATA E PËRCAKTIMIT/KLASIFIKIMIT

DATA NË TË CILËN ZONA ËSHTË KLASIFIKUAR SI SPA²

V	V	V	V	M	M	

REFERENCA LIGJORE KOMBËTARE E PËRCAKTIMIT TË SPA

DATA QË ZONA ËSHTË PROPOZUAR SI SCI³

DATA QË ZONA ËSHTË KONFIRMUAR SI SCI (*)

DATA QË ZONA ËSHTË SHPALLUR SI SAC⁴:

REFERENCA LIGJORE KOMBËTARE E SHPALLJES SË SAC

V	V	V	V	M	M

SQARIME

(**)......
.....
.....

² SPA "Zonë e veçantë e mbrojtur".

³ SCI "Zonë me rëndësi për komunitetin".

⁴ SAC "Zonë e veçantë për konservim".

* Opsionale, data e konfirmimit si SCI e dokumentuar nga DG Environment.

** Opsionale, shpjegimet mund të jepen p.sh. për datat e klasifikimit ose shpalljes si zona që janë të përbëra ose të ndara SPA dhe/ose SCI.

2. VENDNDODHJA E ZONËS

2.1 VENDNDODHJA E QENDRËS SË ZONËS (SHKALLË DECIMALE)

GJATËSI GJEOGRAFIKE

GJERËSI GJEOGRAFIKE

2.2 SIPËRFAQJA (HA)

2.3 SIPËRFAQJA DETARE (%)

2.4 GJATËSI E ZONËS (KM)

2.5 KODI DHE EMRI RAJONIT ADMINISTRATIV

NUTS KODI NIVELI 2

EMRI RAJONAL

2.6 RAJONI BIOGJEOGRAFIK

ALPIN (.....%)(*)
MESDHETAR (.....%)
ATLANTIK (.....%)
PANNONIAN (.....%)
DETI I ZI (.....%)
STEPIK (.....%)

BOREAL (.....%)

KONTINENTAL (.....%)

MAKRONESIAN (.....%)

INFORMACION SHITESË PËR RAJONET DETARE

MARINË ATLANTIKE (.....%)

MARINË DETI I ZI (.....%)

MARINË E DETIT BALTIK (.....%)

MARINË MESDHETARE (.....%)

MARINË MACRONESIAN (.....%)



3. INFORMACION EKOLOGJIK

3.1 Tipat e habitateve prezente në zonë dhe vlerësimi në zonë për to:

Llojet e habitateve të aneksit I					Vlerësimi i zonës			
Kodi	PF	NP	Mbulesa (ha)	Shpella (numër)	AIBICID	AIBIC		
					Përfaqësueshmëria	Sip. relative	Ruajtja	Globalisht

PF: për llojet e habitateve që mund të jenë jo prioritet, si dhe një formë prioriteti (6210, 7130, 9430) vendosni "x" në kolonën PF për të treguar formën prioritare.

NP: në rastin kur një lloj habitati nuk ekziston më vendosni kodin e zonës: x (opsionale)

Mbulesa: mund të vendosen vlera me shifra dhjetore

Shpellat: për tipat e habitatëve 8310, 8330 (shpellat) vendosni numrin e shpellave n.q.s. sipërfaqja e vlerësuar nuk është e vlefshme.

Cilësia e të dhënave: G= e mirë (p.sh. bazuar në studime); M= e moderuar (p.sh. bazuar në të dhëna të pjesshme me disa ekstrapolime); P=e dobët (p.sh. vlerësim i përafërt)

3.2 Llojet e referuara në nenin 4 të direktivës 2009/147/EC dhe llojet e listuara në aneksin II të Direktivës 92/43/EEC dhe vlerësimi i zonës për to

Llojet					Popullata në zonë					Vlerësimi i zonës				
Grupi	Kodi	Emri shkencor	S	NP	Tipi	Numri		Njësia	Kat.	Cilësia e të dhënave	AIBICID	AIBIC		
						Min.	Maks.		CIRIVIP		Pop.	Cons.	Izol.	Glob.

Grupi: A= amfibë, B= shpendë, F=peshk, I=jovertebrorë, M=gjitarë, P=bimë, R=reptile

S: Në rast se të dhënat për llojet janë sensitive dhe prandaj duhet të bllokohen për çdo akses të publikut vendosni “po”.

NP: në rastet kur një lloj nuk është me prezent në zonë vendosni x (opsional).

Tipi: p= i përhershëm, r=riprodhues, c=përqendrim, w=dimërues (për bimët dhe llojet jomigratore përdorni “i përhershëm”).

Njësia: i=individë, p=çifte të njësive të tjera në përputhje me listën e standardizuar të njësive të popullatave në përputhje me nenet 12 dhe 17 të raportimit (shih portalin e referencës).

Kategoritë e sasisë: C= i zakonshëm, R= i rrallë, V= shumë i rrallë, P=prezent – për t’u plotësuar në rast të të dhënave të pamjaftueshme ose përveç informacionit për numrin e popullatës.

Cilësia e të dhënave: G=e mirë, M= e moderuar, P= e dobët, DD= të dhëna të pamjaftueshme



3.3 Lloje të tjera të rëndësishme të florës dhe të faunës (opsionale)

Llojet					Popullata në zonë			Motivacioni						
Grupi	Kodi	Emri shkencor	S	NP	Madhësia		Njësia	Kategoria	Aneksi i llojeve		Kategori të tjera			
					Minimumi	Maksimumi								

Grupi: A=amfibë, B=shpendë, F=peshk, Fu=kërpudha, I=invertebrore, L=likene, M=gjitarë, P=bime, R=reptile,

KODI: për shpendët, llojet e anekseve IV dhe V, kodi siç është dhënë në portalin referues duhet të përdoret së bashku me emrin shkencor.

S: Në rastin kur të dhënat për llojet janë sensitive dhe prandaj duhet të bllokohen për akses nga publiku, shkruani: yes (po)

NP: në rast se një lloj nuk është më prezent në zonë vendosni x: opsional

Njësia: i=individë, p=çifte ose njësi të tjera në përputhje me listën e standardizuar të njësive të popullatave dhe kodet në përputhje me nenet 12 dhe 17 të raportimit (shiko portalin e referencës).

Kategoria: Kategoritë e sasisë: C=i zakonshëm, R=i rrallë, V=shumë i rrallë, P=prezent.

Kategoritë e motivacionit: Llojet e anekseve IV dhe V (direktiva e habitateve), A=të dhëna nga lista e kuqe kombëtare, B=endemike, C=Konventa ndërkombetare, D: arsye të tjera.

4. PËRSHKRIMI I ZONËS

4.1 Karakteri i përgjithshëm i zonës:

Kodi	Klasa e habitatit	Mbulesa (%)
Mbulesa totale e habitatit		100 %

Karakteristika të tjera të zonës

4.2 Cilësia dhe rëndësia

4.3 Kërcënimet, presionet dhe aktivitetet me ndikime në zonë

Ndikimet më të rëndësishme dhe aktivitetet me efekt të madh në zonë

Ndikimet negative			
Renditja	Kërcënimet dhe presionet (kodi)	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i /o/b)
H			
H			
H			
H			
H			

Ndikimet pozitive			
Renditja	Aktivitete, menaxhimi (kodi)	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i/o/b)
H			
H			
H			
H			
H			

Ndikime të tjera të rëndësishme me efekt mesatar/të ulët në zonë

Ndikime negative			
Renditja	Kërcënime dhe presione	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i / o / b)

Renditja: H=i lartë, M=i mesëm, L=i ulët.

Ndotja: N=azoti, P= fosfori/fosfate, A= të dhëna për acide/acidifikimin, T= kimikate inorganike toksike, O= kimikate organike toksike, X= ndotje të ndryshme. i=brenda, o=jashtë, b= të dyja

5. GJENDJA E MBROJTJES SË ZONAVE (OPSIONALE)

5.1 Tipat e mbrojtjes në nivel kombëtar dhe rajonal

Kodi	Mbulesa (%)	Kodi	Mbulesa (%)	Kodi	Mbulesa (%)

5.2 Lidhja e zonës së përshkruar me zonat e tjera: të shpallura në nivel kombëtar dhe rajonal

Lloji i kodit	Emri i zonës	Tipi	Mbulesa (%)

të shpallura në nivel ndërkombëtar

Lloji	Emri i zonës	Lloji	Mbulesa (%)
Zona Ramsar			
Rezerva biogjenetike			
Zonë eurodiplomë			
Rezerve biosfere			
Sitë i Konventës së Barcelonës			
Sitë e Konventës së Bukureshtit			
Zonë e trashëgimisë botërore			
Zonë HELCOM			
Zonë OSPAR			

5.3 Shpallja e zonës

--



6. MENAXHIMI I ZONËS

6.1 Organet përgjegjëse për menaxhimin e zonës:

Organizata:	_____
Adresa:	_____
E-mail:	_____

6.2 Planet e menaxhimit:

Ekziston një plan menaxhimi për zonën:

Po

Emri: _____

Linku: _____

Emri: _____

Linku: _____

Jo, por është në përgatitje

Jo

6.3 Masat mbrojtëse (opsionale)

--

7. HARTA E ZONËS

INSPIRE ID

Harta e dorëzuar në PDF në formë elektronike (opsionale)

Po

Jo

Referenca(t) e hartës origjinale të përdorura për digitalizimin e kufijve elektronikë (opsionale)

VENDIM

Nr.898, datë 21.12.2011

PËR SHPALLJEN E EKOSISTEMIT NATYROR MALOR KORAB - KORITNIK “PARK NATYROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 4/2, 9, 13 e 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror malor Korab - Koritnik “Park natyror”, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij parku natyror janë, si më poshtë vijon:

a) Veri:

Pika 1, me koordinata 4455778.15L e 4659256.82V, pranë urës së lumit Luma, ndjek kanalin e Lumës, ndërpret lumin e Lumës, i ngjitet kurrizit ndërmjet fshatit Përbreg dhe qafës së Zbinecit, vijon me kuotat 462.6 m, 1549.0 m, 1361.0 m, 1293.0 m, 1223.0 m, 1150.1 m, 1021.0 m, zbret kurrizin deri te pika 2, me koordinata 4463004.61L e 4668805.51V, pranë Morinës.

b) Lindje:

Pika 2, me koordinata 4463004.61L e 4668805.51V, pranë Morinës, vijon përgjatë kufirit shtetëror me Kosovën dhe Maqedoninë deri te pika 3, kuota 2174.7 m, me koordinata 4463238.36L e 4605429.25V.

c) Jug:

Pika 3, kuota 2174.7 m, me koordinata 4463238.36L e 4605429.25V, vijon përgjatë kufirit shtetëror me Maqedoninë deri te pika 4, me koordinata 4459468.97L e 4603467.39V.

d) Perëndim:

Pika 4, me koordinata 4459468.97L e 4603467.39V, vijon përgjatë rrugës në drejtim të fshatit Kllobçisht, kalon në anën e poshtme të fshatit Kërçishti i Epërm, sipër fshatit Kërçishti i Poshtëm dhe fshatit Pocesti, ndjek përroin e Hollobukut, vijon në drejtim të fshatit Popinare, në drejtim të kuotës 1026.0 m (k. Tuma Punjos), kalon poshtë kuotës 1474.9 m, ndërpret përroin e Melanit, i ngjitet kurrizit në drejtim të fshatit Ilnica, vijon me kuotat 1500.0 m, 1504.0 m (m. Buravajkut), 1474.6 m (m.Grevës), ndjek rrugën në drejtim të kuotës 837.0 m, ndërpret Përroin e Banjës (pranë Llixhave), i ngjitet kurrizit të malit të Staravecit, kalon Qafën e Malit, kuotën 1635.0 m, ndjek kurrizin e malit të Vakufit dhe të Gramës, ndjek rrugën në Livadhet e Vrenjtit, kuotën 1626.0 m, kurrizin e faqes së Gradishtës, kuotat 1345.0 m (k. Mëllezës) e 1034.0 m, ndërpret përroin e Gramës, kalon sipër fshatit Dipjakë, në kodrën e Frizmajt, ndjek rrugën për në fshatin Venisht, ndërpret përroin e Shëngjergjit, kuota 1250.0 m, ndjek



rrugën sipër fshatit Sllatinë, kuota 1016.8 m (m. Guri i Zi), vijon me rrugën, i ngjitet kurrizit mbi fshatin Vleshë, kuota 1135.0 m, 1241 m, ndjek rrugën e zbret kurrizin, kalon mbi urën e lumit të Radomirës, vijon me lumin e Veleshicës, më pas i ngjitet kurrizit, kuota 1017.3 m, kalon poshtë fshatit Cereni, ndërpret Përroin e Rrasës, ndjek rrugën, kuotat 1161.0 m, 1159.0 m, 1167.0 m, 1187.0 m, ndjek rrugën poshtë majës së Sukës (1289.0 m), ndërpret përroin e Bushtricës, ndjek përroin e Vasijas, kalon nëpër degën e djathtë të rrjedhës së tij, ndërpret Përroin e Ahut dhe ndjek degën e djathtë të tij (kufiri midis Dibrës e Kukësit), pranë fshatit Bushtrica (Gjanaj), kuota 1442.8 m (Mali i Baklit), vijon përgjatë kurrizit, ndërpret përroin e Çajës, ndjek degën e krahut të djathtë të tij, kuota 1413.8 m (Mali e Mollës), ndjek rrugën, kuota 1452.0 m (m. Bakisë), vijon përgjatë rrugës, kuota 1582.0 m, vijon me rrugën, kuota 1522.0 m, kalon në qafën e Dardhës, kuota 1515.0 m (m. Kumashit), vijon përgjatë kurrizit dhe rrugës, ndërpret përroin e Tërshanës, në grykën e kanionit të Bicajt, vijon përgjatë rrugës sipër fshatit Nanga, Nanga (Krezë) dhe Shtiqën, më pas ndjek kanalën e Lumës deri te pika 1, me koordinata 4455778.15L e 4659256.82V, pranë urës së lumit Luma.

3. Parku natyror Korab - Koritnik ka sipërfaqe të përgjithshme 55 550.2 (pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë pikë dy) ha, nga të cilat në qarkun e Kukësit 34 886.8 (tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tetë) ha dhe në qarkun e Dibrës 20 663.4 (njëzet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tri pikë katër) ha.

Pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me kullota e livadhe, të ndjekura nga sipërfaqet pyjore e me bimësi pyjore, sipërfaqet joproduuese, sipërfaqet bujqësore, si dhe sipërfaqet urbane e troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Parku natyror Korab-Koritnik ndahet në 3 nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Nënzona qendrore, me sipërfaqe 4 374.3 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër pikë tre) ha, e shënuar në hartë me ZQ, nga të cilat në qarkun e Kukësit 2 753.3 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tri pikë tre) ha dhe në qarkun e Dibrës 1 621.0 (një mijë e gjashtëqind e njëzet e një pikë zero) ha.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë, si dhe kullotja sezonale.

b) Nënzona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 49 603.9 (dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tri pikë nëntë) ha, e shënuar në hartë me ZPT, nga të cilat në qarkun e Kukësit 31 869.4 (tridhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë katër) ha dhe në qarkun e Dibrës 17 734.5 (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë pesë) ha.

Kjo nënzona përfshin tërësisht tokat bujqësore, pyjet e kullotat, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si bujqësi, pyje, kullotja, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtime të veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Në nënzona e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës, sipas planeve të zhvillimit urban e turistik, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

c) Nënzona e zhvillimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe 1572.0 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy pikë zero) ha, e shënuar në hartë me ZZHQ, nga të cilat në qarkun e Kukësit 264.1 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë një) ha dhe në qarkun e Dibrës 1 307.9 (një mijë e treqind e shtatë pikë nëntë) ha.

Kjo nënzona përfshin territoret urbane dhe trojet e përziera me tokë bujqësore e pyjore pranë qendrave të banuara dhe veprimtaritë përgjatë lumenjve, përfshirë edhe ujërat termale. Nënzona mundëson vazhdimin e veprimtarive ekonomike, sociale e të agrobiznesit të qëndrueshëm dhe përdorim të balancuar të peizazhit e të burimeve natyrore, si dhe shtimin e drurëve arrorë, lajthive, gështenjave e

të bimëve mjekësore dhe aromatike. Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes. Në këtë nënzonë lejohen veprimtari dhe ndërtimi i infrastrukturës, të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe që nuk bien ndesh me programet e zhvillimit të turizmit e mjedisit për qarkun, me planet e zhvillimit të komunave, me planet e menaxhimit të pyjeve e kullotave komunale dhe që kryhen sipas planeve të zhvillimit urban e turistik, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), e ushtrohen vetëm me leje mjedisore.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ministrinë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shkencore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e biznesit dhe pronarët privatë, merr masa për të hartuar planin e integruar të menaxhimit të parkut natyror Korab-Koritnik, në përputhje me objektivat e menaxhimit të rrjetit ekologjik të vendit dhe programet e zhvillimit rajonal e vendor.

6. Për veprimtaritë turistike të zbatohen kriteret dhe standardet e përcaktuara në ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për rastet e trashëgimisë kulturore, veprimtaritë mundësohen me leje të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9806, datë 17.9.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike””. Përvetësimi i objekteve me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

7. Autoriteti shtetëror, që ngarkohet me administrimin e zonës së mbrojtur, janë strukturat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Administratat ekzistuese të sektorëve pyjorë (Kukës e Dibër), që përfshihen brenda sipërfaqes së parkut natyror, do të kryejnë funksionet e administratës së parkut natyror Korab-Koritnik, sipas ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.


8. Ngarkohen, sipas përkatësisë, ministrinë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SASIA E SIPËRFAQEVE, SIPAS PËRBËRJES

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja ha		
		Qarku Kukës	Qarku Dibër	Totali
1	Sipërfaqe pyjore, shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore dhe ujore	10 981.9	7 430.7	18 412.6
2	Sipërfaqe kullimore e livadhe	13 026.2	9 104.0	22 130.2
3	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtore)	3 716.2	1 309.3	5 025.5
4	Sipërfaqe ujore (lumenj, përrenj, liqene, ujëmbledhës)	33.3	9.4	42.7
5	Sipërfaqe joproduuese (shkëmbore, zhavorriste e zhveshur)	6 857.8	2 759.3	9 617.1
6	Sipërfaqe urbane dhe troje të përzier me tokë bujqësore, pyjore e kullimore	271.4	50.7	322.1
	Sipërfaqe e përgjithshme	34 886.8	20 663.4	55 550.2



KËRKESE

Shtetasi Muharrem Kuburja, i biri i Maliqit, i datëlindjes 15.7.1960, lindur dhe banues në Elbasan, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të motrës së tij Drita Kuburja.

KËRKUESI
Muharrem Kuburja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.1.2012
Doli nga shtypi më 20.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë